



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

---

I.GJA.nr.1/2023-37  
Me datë 14.04.2023

***RAPORTI PËR PUNËN E GJYKATËS THEMELORE NË PRIZREN DHE DEGËVE TË  
SAJ NË DRAGASH DHE SUHAREKË PËR TRE MUJORIN E PARË ( JANAR – SHKURT  
– MARS 2023)***

Në kuptim të nenit 14 paragrafi 2 nën paragrafi 2.5 të Ligjit për Gjykatat, paraqes raportin për tre mujorin e parë (*Janar – Shkurt – Mars 2023*).

Tashmë është e njohur që nga Janari i vitit 2023, Gjykata Themelore në Prizren funksionon në dy objekte, pra Divizioni Civil në objektin përcjellës të Gjykatës që është funksionalizuar në tërësi, që ka qenë edhe një ndër qëllimet kryesore me të marrë detyrën e Kryetares së Gjykatës.

Marrë në përgjithësi në aspektin e efikasiteti dhe zgjidhjes së lëndëve, Gjykata Themelore në Prizren ka një normë të lartë të zgjidhjes së lëndëve në të gjitha Departamentet dhe Divizionet, në disa kemi dyfishim të zgjidhjes së lëndëve, ka një rënie e numrit të rasteve në punë në Divizionin Civil.

Sipas vendimit të KGJK-së, Gjykata Themelore në Prizren ka pranuar në kompetencë dhe punë disa lëndë në Departamentin e Krimeve të Rënda nga Gjykata Themelore në Mitrovicë, këto lëndë janë ndarë dhe menjëherë caktuar tek Gjyqtarët, të cilët janë udhëzuar që ti trajtojnë këto raste, në bashkëpunim me Prokurorinë e Shtetit dhe palët në procedurë që të mos ketë seanca jo produktive dhe dështim të seancave të paarsyeshme.

Tashmë Gjykata Themelore në Prizren pas një riorganizimi, ka një ritëm të punës që qon në trendë pozitive sa i përket rezultatit dhe efikasiteti dhe organizimit dhe shpërndarjes së punës.

Nga data 1 Maj 2023, 2 (Dy) Gjyqtarë në Prizren, dhe një (1) Gjyqtare në Suharekë fillojnë angazhimin e tyre të plotë (pas përfundimit të trajnimit 1 vjeçar), dhe të njëjtit janë caktuar në Divizionin Civil, duke parë nevojën për trajtimin e këtyre rasteve, vëllimin e lëndëve dhe faktin se trajtimi i lëndëve Civile ndikon drejtpërdrejt në perceptimin e publikut dhe rrit besueshmërinë e palëve në Institucionet tona.

Gjithashtu Gjykata Themelore në Prizren do të ketë edhe 4 (katër) Gjyqtarë më shumë, pas dekretimit me datë 07 Prill, ashtu që numri i Përgjithshëm i Gjyqtarëve në Gjykatën Themelore në Prizren, dhe Degët Suharekë & Dragash, është 38 (përfshirë 4 Gjyqtarët e sapo dekretuar).

Kjo rrit nevojën për mbështetjen e Gjyqtarëve me bashkëpunëtor profesional dhe staf administrativ sikurse Zyrtar Ligjor dhe Referentë, andaj shpresojmë që Sekretariat i KGJK-së ta ketë parasysh në konkurset e ardhshme.

Ndër të tjera, si kryetare e gjykatës në ditë të caktuara organizojmë “ditën e hapur” dhe presim në takim qytetarët dhe palët e interesuara, shqetësimet dhe kërkesat e të cilëve i adresojmë dhe i trajtojmë me gjyqtarët dhe stafin mbështetës.

Në tre mujorin e katërt rregullisht kemi pasur takime me gjyqtarët e divizioneve të caktuara, ndërsa në fillim të muajit Prill, është mbajtur kolegji i rregullt me gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional, ku është diskutuar efikasiteti i punës Gjithashtu në këtë kolegji diskutim kryesor kanë qenë dy planet e KGJK-së për trajtimin e lëndëve me prioritet të lartë.

Sa i përket procesit të regjistrimit të lëndëve për asgjësim, deri më tani në Gjykatën Themelore në Prizren kemi arritur të bëjmë regjistrimin e lëndëve të kundërvajtjes për asgjësim deri në vitin 2015. Gjykata Themelore Prizren – Dega në Dragash deri më tani ka arritur të regjistroj lëndët e kundërvajtjes për asgjësim deri në vitin 2017. Në këtë drejtim janë angazhuar 6 punëtor për regjistrimin e lëndëve për asgjësim nën mbikëqyrjen e Administratores dhe Udhëheqëses së Zyres për Menaxhimin e Lëndëve.

***1. Përbushja e obligimeve që rrjedhin nga Plani Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022 – 2025, dhe Plani strategjik për zgjidhjen efikase të lëndëve të Korrupsionit dhe Krimin të organizuar 2022-2024, dhe plotësimi i formularit për lëndët e korrupsionit dhe krimin e organizuar – Trajtimi i lëndëve me prioritet?***

Referuar kësaj pike të diskutimit, ju njoftoi se gjatë tremujorit të 1-rë të vitit 2023, kemi përpiluar raporte të detajuara dhe kemi konstatuar gjendjen me lëndë aktive dhe në punë, ndarë në vite dhe natyrë të lëndëve.

Me Gjyqtarët e secilit Divizion kemi pasur takime të veçanta ku kemi identifikuar detyrat dhe përgjegjësitë nga Planet Strategjike.

Nga secili Gjyqtar kemi pranuar raport për lëndët që kanë në punë, duke i ‘u referuar kërkesave dhe detyrave që rrjedhin nga Plani Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi.

Tashmë kemi identifikuar të gjitha lëndët në zyrën e secilit Gjyqtar (Civile, Penale dhe Krime të Rënda), të cilat do të kenë fokus të veçantë në trajtimin e tyre komform detyrave nga Planet Strategjike dhe në Kolegjiumin e mbajtur me dt. 07.04.2023 i kemi përcaktuar detyrat afatshkurta dhe afatgjata për planin e punës. Është përcaktuar që deri në tremujorin e dytë duhen të caktohen të gjitha lëndët më të vjetra se viti 2011 dhe të përfundojnë sipas mundësisë. Duhet të caktohen lëndët më të vjetra se viti 2016 dhe lëndët që janë afër parashkrimit 6 muaj dhe lëndët në rigjykim. Objektivi është që të zvogëlohet numri i këtyre lëndëve dhe do të bëhet krahasimi për secilin gjyqtar se sa ka arritur të përmbushë këtë objektiv gjatë këtyre tre muajve në vijim.



***Përfomanca e Gjykatës – Departamenteve dhe Divizioneve e shprehur në normë efikasiteti në %.***

Në tremujorin e 1-rë të vitit 2023, në tërësi si gjykatë kemi rezultuar me rritje të efikasitetit, në bazë të përqindjeve në lëndët e pranuar dhe atyre të zgjidhura.  
E shprehur dha paraqitur në % norma e efikasiteti është si në vijim:

**Gjykata Themelore Prizren**

**PENALE**

**D. Krime të Rënda** — Norma e zgjidhjes së lëndëve **124 % (46 lëndë të zgjidhura)**  
**D. Mitur** - Norma e zgjidhjes së lëndëve **184 % (35 lëndë të zgjidhura).**  
**Penale Përgjithshme** – Norma e zgjidhjes së lëndëve **82 % (124 lëndë të zgjidhura).**

**CIVILE**

**Divizioni Civil** – Norma e përgjithshme e zgjidhjes së lëndëve **97%**  
**Kontestimore** – Norma e zgjidhjes së lëndëve **66%. (769 Lëndë të zgjidhura)**  
**JoKontestimore** – Norma e zgjidhjes së lëndëve **98% (61 lëndë të zgjidhura)**  
**Përmbartimore** – Norma e zgjidhjes së lëndëve **208% (1,055 Lëndë të zgjidhura)**  
**Kundërvajtje** – Norma e zgjidhjes së lëndëve **66% (432 Lëndë të zgjidhura).**

Pra në lëmine Penale kemi një normë efikasiteti në rritje nga muajt paraprak, sidomos në Departamentin e Krimeve të Rënda dhe për të Mitur. Ndërsa në Divizionin Civil ka një efikasitet të lartë të zgjidhjes së lëndëve, sidomos lëndët përmbartimore ku qytetarët presin drejtpërdrejt realizimin e një të drejte, pasi që numri i lëndëve aktive nga 1, 500 tashmë është në 600 lëndë në pritje.

Kjo është rezultat i angazhimit të të gjithë gjyqtarëve në këtë divizion dhe rritjes së numri të bashkëpunëtorëve.

Për të mbajtur në rritje punën dhe efikasitetin pos Gjyqtarëve dhe Bashkëpunëtorëve profesional gjithsesi që duhet plotësimi i vendeve të punës edhe në stafin administrativ dhe mbështetës. Për këtë në fillim të vitit 2023 kemi dërguar një kërkesë në KGJK, për plotësimin e vendeve të punës dhe mungesat që i ka Gjykata Themelore në Prizren dhe dega në Suharekë.

Për më tepër bashkëngjitur keni tabelat e ndara në mënyrë specifike trajtimin e lëndëve sipas natyrës.

***Gjykata Themelore - Dega në Suharekë***

Aktualisht në këtë gjykatë janë 4 gjyqtarë, dy në lëmine civile dhe dy në lëmine penale, kurse për lëndët e divizionit të kundërvajtjes që nga Janari i 2023 këto lëndë do ti trajtojnë Gjyqtarët e Divizionit Penal.

Nga data 1 Maj Divizionit Civil i shtohet edhe një Gjyqtare.

Efikasiteti i shprehur në %.

#### Gjykata Themelore – Dega SUHAREKË

**Divizioni Civil** – Norma e përgjithshme e zgjidhjes së lëndëve 62%  
**Kontestimore** – Norma e zgjidhjes së lëndëve 46%. (150 Lëndë të zgjidhura)  
**JoKontestimore** – Norma e zgjidhjes së lëndëve 106% (34 lëndë të zgjidhura)  
**Përmbartimore** – Norma e zgjidhjes së lëndëve 23% (174 Lëndë të zgjidhura)  
**Kundërvajtje** – Norma e zgjidhjes së lëndëve 236% (402 Lëndë të zgjidhura).

#### PENALE

**Penale Përgjithshëm** – Norma e zgjidhjes së lëndëve 99 % (106 lëndë të zgjidhura).

Duke marrë parasysh numrin e Gjyqtarëve ku gjatë vitit 2022 janë pensionuar tre (3) Gjyqtarë, dhe stafin administrativ, kjo Gjykatë tregon një efikasitet dhe një organizim të mirë të punës dhe ndarjes së barabartë të punës dhe lëndëve.

Gjyqtari mbikëqyrës i kësaj gjykate Selajdin Gallapeni pret në takim palët dhe personat e interesuar, ku ankesat dhe kërkesat e të cilëve i adreson te gjyqtarët.

#### *Gjykata Themelore - Dega në Dragash*

Në këtë gjykatë funksionojnë gjyqtari mbikëqyrës i cili njëkohësisht punon edhe në Gjykatën Themelore në Prizren, kurse në degën në Dragash është i angazhuar në divizionin penal si dhe një gjyqtare e cila është e angazhuar në të gjitha lëmi.

Efikasiteti i shprehur në %.

#### Gjykata Themelore – Dega DRAGASH

**Divizioni Civil** – Norma e përgjithshme e zgjidhjes së lëndëve 96%  
**Kontestimore** – Norma e zgjidhjes së lëndëve 66%. (50 Lëndë të zgjidhura)  
**JoKontestimore** – Norma e zgjidhjes së lëndëve 180% (9 lëndë të zgjidhura)  
**Përmbartimore** – Norma e zgjidhjes së lëndëve 23% (174 Lëndë të zgjidhura)  
**Kundërvajtje** – Norma e zgjidhjes së lëndëve 12% (9 Lëndë të zgjidhura).

#### PENALE

**Penale Përgjithshëm** – Norma e zgjidhjes së lëndëve 76 % (19 lëndë të zgjidhura).

**PËR MË TEPËR BASHKËNGJITUR GJENI RAPORTE NË TABELA TË VECANTA**



## **2. Raportim për publikim të vendimeve;**

Publikimi i vendimeve Gjyqësore tashmë një detyrë dhe obligimi ligjor, të cilin Gjykata Themelore në Prizren e përmbush në harmoni me Udhëzimet Administrative.

Lidhur me këtë, ne kemi shikuar dhe vlerësuar raportin e Lëvizjes FOL, dhe ashtu sikurse në të kaluarën do të marrim parasysh komentet dhe vlerësimet e tyre.

Gjykata Themelore në Prizren në raportin e Lëvizjes Fol në bashkëpunim me mbështetjen e INL, ka pasur një vlerësim të mirë sa i përket publikimit të vendimeve që janë në përputhje me Udhëzimet Administrative. Do të kujdesemi që gjatë vitit 2023, të mundësojmë publikimin e të gjitha vendimeve që janë për publikimin, duke shpërndarë në mënyrë të barabartë punën, edhe pse procesi i shkarkimit të vendimeve nga sistemi, anonimizimit, konvertimi dhe publikimi përfundimtar kërkon shumë persona dhe shumë punë mekanike, merr edhe kohë, mirëpo kjo tashmë është një obligim ligjor, që ka ndikuar jashtëzakonisht shumë në besimin e publikut, dhe ka rënë numri i kërkesave për vendime, pasi që palët dhe organizata që përcjellin punën e Gjykatës tashmë këto vendime i sigurojnë përmes web faqes së Gjykatës.

Përpos vendimeve për rastet që trajtohen, Gjykata vazhdon ti publikoj brenda afatit ligjor edhe vendimet për rastet disiplinore që trajtohen nga Autoriteti Kompetent.

Në tre mujorin e 1-rë, Gjykata Themelore në Prizren në Total ka publikuar 989 vendime Gjyqësore. Nga ky numër i Përgjithshëm janë 828 vendime të Gjykatës Themelore Prizren, 116 Gjykata Themelore – Dega në Suharekë, dhe 50 vendime Gjykata Themelore e- Dega në Dragash. Ndarë sipas natyrës së këndeve, janë 549 vendime Civile, 349 Divizioni Penal, 58 Krime të Rënda, dhe 33 vendime të tjera.

## **3. Angazhimi i Bashkëpunëtorëve Profesional:**

Aktualisht në Gjykatën Themelore në Prizren janë të angazhuar 18 bashkëpunëtor profesional, ku 2 prej tyre punojnë në Degën e Gjykatës në Dragash, ndërsa 4 bashkëpunëtor janë në degën e gjykatës në Suharekë. Në konkursin e fundit është rekrutuar një pozitë e bashkëpunëtorit për në Prizren, ku pritet të filloj punën.

Vlen të përmendet fakti se pavarësisht përpjekjeve që të angazhojmë një bashkëpunëtor të punojë me një gjyqtar, momentalisht është e pamundur sepse tani më 3 bashkëpunëtor të gjykatës sonë janë dekretuar gjyqtar të Republikës së Kosovës dhe tani sërish kemi mungesë të bashkëpunëtorëve që të punojnë një bashkëpunëtorë me një gjyqtarë, sepse e dimë se tanimë Gjykata e Themelore në Prizren ka gjithsej 38 gjyqtar, ndërsa ka 18 bashkëpunëtorë.

Në lëminë civile janë të angazhuar 5 bashkëpunëtor, ndërsa në lëminë penale 13 ku 3 prej tyre në departamentin për krime të rënda, një në departamentin për të mitur, ndërsa të tjerët në departamentin e përgjithshëm – divizioni penal.

Një bashkëpunëtorë është e angazhuar në procedurën e anonimizimit e aktgjykimeve.

#### **4. Referimi i rasteve Gjyqësore në ndërmjetësim;**

Referuar rasteve të ndërmjetësimit në tremujorin e I-rë, janë si në vijim:

**JANAR** janë referuar 30 raste në ndërmjetësim: 24 Penale dhe 6 Civile.

15 lëndë janë përfunduar me marrëveshje, kurse 15 lëndë janë aktive.

**SHKURT**, janë referuar 31 raste në ndërmjetësim: 19 Penale dhe 12 Civile.

15 lëndë janë përfunduar me marrëveshje.

4 lëndë janë kthyer në procedurë të rregullt Gjyqësore – pra nuk ka pasur marrëveshje.

12 lëndë janë aktive në proces.

**MARS**, janë referuar 56 raste në ndërmjetësim: 30 Penale dhe 26 Civile.

21 lëndë janë përfunduar me marrëveshje.

7 janë kthyer në procedurë të rregullt Gjyqësor – pra nuk ka pasur marrëveshje.

28 lëndë janë aktive në proces.

Gjykata Themelore në Prizren ka të caktuar një bashkëpunëtoresh profesionale si referente për ndërmjetësim, e cila ka edhe një zyrtare të punësuar me projekt të USAID, e që kjo ka sjellë rezultat efikas në punë, gjë për të cilën e falënderojmë USAID për mbështetjen.

Në Gjykatë ka një zyre të veçantë për trajtimin e rasteve për ndërmjetësim.

Gjithashtu synojmë që në fillim të vitit 2023, edhe në Gjykatën Themelore – Dega në Suharekë të krijojmë një hapësirë të veçantë dhe të caktojmë një zyrtar për trajtimin e rasteve për ndërmjetësim.

#### **5. Veprimet e ndërmarra lidhur me Raportin inspektues të Njësisë për Inspektim Gjyqësor për rishikimin e faktorit kohor në dërgimin/pranimin e lëndëve gjyqësore sipas kompetencës lëndore dhe territoriale në gjykatë (veçanërisht Gjykata Themelore Prishtinë)**

Sa i përket rishikimit të faktorit kohor për dërgimin/pranimin e lëndëve gjyqësore sipas kompetencës lëndore dhe territoriale në gjykatën tonë nuk kemi pasur probleme të theksuara, por vetëm raste të izoluar të cilat edhe janë kryer gjer më tani.

#### **6. Ekzekutimi i dënimeve në procedurën civile dhe penale;**

*Gjykata Themelore Prizren*

*Ekzekutimet civile:*

Në tremujorin e I-rë të vitit 2023, nga viti 2022 janë trashëguar 4984 lëndë përmbarrimore, ndërsa janë pranuar gjatë këtij tremujori 471 lëndë përmbarrimore, ku gjithsej në punë janë 5455 lëndë



përmbartimore. Gjatë këtij tremujori të I-rë të vitit 2023 janë kryer 359 lëndë dhe aktualisht në punë janë 5096 lëndë përmbartimore.

#### *Ekzekutimet penale:*

Në tremujorin e parë të vitit 2023 janë pranuar 375 lëndë të ekzekutimeve penale, respektivisht 39 lëndë të ekzekutimeve të dënimeve me burgim, ndërsa 336 lëndë të ekzekutimeve të dënimeve me gjobë. Gjatë kësaj periudhe janë kryer 352 lëndë, 30 lëndë të ekzekutimeve të dënimeve me burgim dhe 322 lëndë të ekzekutimeve të dënimeve me gjobë.

#### *Ekzekutimet kundërvajtëse:*

Për arsye të disa ndryshimeve për organizimin e brendshëm të gjykatës, referenti i ekzekutimeve kundërvajtëse ka raportuar se me datë 30.01.2023 ka pranuar lëndë të trashëguara 1398 lëndë, ndërsa gjatë këtij tremujori janë pranuar 208 lëndë, gjithsej në punë janë 1606 lëndë, ku me pagesa janë kryer 284 lëndë, ndërsa rreth 400 lëndë janë parashkruar. Tani në punë janë 867 lëndë të ekzekutimeve kundërvajtëse.

Gjykata Themelore – Dega në Suharekë

Gjatë tremujorit të parë janë pranuar 700 lëndë të ekzekutimeve përmbartimore, ndërsa janë kryer 174 lëndë.

Gjykata Themelore – Dega në Dragash

Gjatë tremujorit të parë janë pranuar 25 lëndë të ekzekutimeve përmbartimore, ndërsa janë kryer 104 lëndë.

### **7. Trajtimi i rasteve të shënjestruara**

Në Gjykatën Themelore në Prizren, në tremujorin e I-rë, Në Departamentin për Krime të Rënda, për rastin e shënjestruar “Infrakos”, shpallja e vendimit ishte bërë në fund të vitit 2022, kurse në Janar është përpiluar vendimi, andaj ky rast tashmë ka marrë epilog në shkallë të I-rë.

Gjithashtu në këtë Departament është rikthyer në rigjykim një rast (SHKOLLA), për një pikë të aktakuzës për një të akuzuar (në fillim kanë qenë 3 të akuzuar për disa pika të aktakuzës). Kjo lëndë nga Departamenti i Krimeve të Rënda, është bartur në Departamentin e Përgjithshëm për shkak të kompetencës sa i përket natyrës së veprës penale për të cilën rasti është kthyer në rivendosje.

Ashtu që në vitin 2023 kemi një rast aktiv i shënjestruar me shenjen “LV”.

### **8. Çështja e seancave të shtyra dhe arsyet e shtyrjes**

Në të gjitha takimet me Gjyqtarët e Divizioneve dhe kolegjiomet, në vazhdimësi kemi diskutuar për të evituar sa më shumë seanca jo produktive. Pra Gjyqtarët kanë kujdes maksimal që të njoftohen të gjitha palët në rast të dështimit të seancave me kohë, ashtu që edhe përmes e-mailit zyrtar të Gjykatës në vazhdimësi kemi komunikime me palë, avokatë dhe institucione të tjera të përfshira në procedurë, në rast kur dihet paraprakisht se do të dështon një seancë.

Nga Departamenti i Krimeve të Rënda kemi kërkuar që të ketë caktim të seancave të njëpasnjëshme, dhe kjo është duke u praktikuar ashtu që për një rast caktohen 2-3 ditë seanca.

Dhe është kërkuar kujdes i veçantë në caktimin e seancave në rastet që janë në fokus të Planeve Strategjike dhe rasteve me interes të lartë.

Këto janë të dhënat të përpunuara nga sistemi SMIL për shtyrje të seancave

### *Gjykata Themelore Prizren*

Sa i përket shtyrjes së seancave në bazë të të dhënave të siguruar nga sistemi SMIL në **Departamentin e Krimeve të Rënda**, në tremujorin e I-rë, janë shtyrë 33 seanca gjyqësore.

10 mosparaqitja e të pandehurit, 6 mosparaqitja e dëshmitarit, 5 mosparaqitja e avokatëve, dhe të tjerat për arsye të tjera.

Në një rast Gjyqtarja e rastit për mosparaqitje të pa arsyeshme të Avokatit ka shqiptuar edhe Gjobë.

**Në Departamentin për të Mitur**, në tremujorin e I-rë, janë shtyrë 12 seanca.

5 seanca në mungesë të të akuzuarit dhe të tjera sipas detyrës zyrtare të arsyetuara.

**Në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Penal**, në tremujorin e I-rë, janë shtyrë 153 seanca.

108 për shkak të mosparaqitjes së të pandehurit, 11 mosparaqitja e dëshmitarit, 23 sipas detyrës zyrtare të arsyetuara, kurse pjesa tjetër për arsye të tjera.

**Në Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni Civil**, në tremujorin e I-të janë shtyrë gjithsej 35 seanca Gjyqësore. Shumica për shkak të mosparaqitjes së palëve apo me kërkesë të palëve për shtyrje të seancës.

### *Gjykata Themelore – Dega Suharekë*

**Në Divizionin Penal** në tremujorin e I-rë, janë shtyrë 44 seanca.

29 mosparaqitja e të pandehurit, 7 sipas detyrës zyrtare të arsyetuara, dhe të tjerat për arsye të tjera.

**Në Divizionin Civil** në tremujorin e I-rë, janë shtyrë 8 seanca.

2 për mungesë të palëve, 6 me kërkesë të palëve ndërgjyqës.

### *Gjykata Themelore – Dega Dragash*



Në Divizionin Penal në tremujorin e I-rë, janë shtyrë 9 seanca.

Në Divizionin Civil në tremujorin e I-rë, janë shtyrë 53 seanca.

Rreth 80 % për shkak të mosparaqitjes së palëve dhe me kërkesë të palëve ndërgjyqëse për shtyerje të seancave.

Këto statistika janë marrë nga Sistemi SMIL i cili i përpunon të gjitha shënimet të cilat gjyqtarët dhe zyrtaret që punojnë me gjyqtarë i evidentojnë në këtë sistem.

**9. Si qëndron gjendja në gjykatën tuaj me lëndët e shujtave, pagave jubilarë dhe kontestet e punës?**

Në këtë periudhë, secili Gjyqtar ka mesatarisht nga 250 deri në 300 lëndë të kësaj natyre. Mirëpo tashmë me shkëputjen e kontratës kolektive në muajin Nëntor të vitit 2022, konsiderojmë që deri në Qershor të vitit 2023 do të trajtohen 80 % e rasteve nga kontrata kolektive dhe do të ketë një rënie të rasteve në punë ashtu që gjykata do të shkarkohet nga këto raste të cilat viteve të fundit kanë krijuar një ngarkesë jashtëzakonisht të madhe, që ka ndikuar negativisht edhe në normë të efikasitetit.

Gjithashtu edhe lëndë Përmbartimore nga 1,500 sa kanë qenë, tashmë janë 600 lëndë aktive që rrjedhin nga kontrata kolektive.

Në përgjithësi deri më datë 31 mars (fund i tremujorit të 1-rë) në Gjykatën Themelore në Prizren, janë pranuar 1,158 lëndë të natyrës Kontestimore.

Nëse shikojmë secilin Gjyqtar veç e veç, në fund të tremujorit të 1-rë kemi Gjyqtarë me 950 lëndë në pritje dhe Gjyqtar me 1,100 lëndë në pritje, lëndë të të gjitha natyrave jo vetëm të shujtave dhe pagave jubilarë. Ka një rënie të numrit të rasteve në pritje sa ka qenë rreth 1,250 kjo si rezultat i zgjidhjes së rasteve të lëndëve me shujta, pagave jubilarë dhe konteste pune në forma tjera, pra pa shqyrtim kryesor të çështjes.

**Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prizren**



Gjykata Themelore

PRIZREN

Sipas referencës:

GjA. nr.

I.Gja.nr.1/2023-36

Të datës:

31.03.2023

KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

R A P O R T

për punët e kryera



Periudhat raportuese		
Të vitit	Kohët e vitit	
2022	Çereku I.	2023
	Çereku II.	
	Çereku III.	
	Çereku IV.	
Tërësisht për vitin		

I. Nga menaxhimi i përgjithshëm:

1.

1. Juridiksioni i gjykatës									
Është gjykatë themelore e rajonit të		PRIZRENIT		me Komunat rrethuese					
Kjo gjykatë themelore			Sipas degëve të veta, të cilat						
Funksionon në qytetin e:	Vendos sipas departamenteve:			Funksionojnë në:		Vendosin sipas departamentit nr.5:			
	1. Krime të rënda			1	SUHAREKË	5. I përgjithshëm sipas divizioneve:	Penal		
	2. Për të mitur								
	3. I përgjithshëm sipas divizioneve:			Civil	2			DRAGASH	Civil
				Kundervajtje	3				Kundervajtje
				Egzekutime	4				Egzekutime
Komenti:									

2.



2. Numri dhe struktura e të punësuarve

2.1 Numri i gjyqtarëve sipas angazhimit në punë, paraqitur strukturën gjinore dhe përkatësinë nacionale:																									
<b>Gjykata themelore + Degët e gjykatës</b>												<b>Aprovuara</b>		<b>46</b>		<b>Plotësuara</b>		<b>35</b>		<b>Lira</b>		<b>11</b>			
<b>Shqiptar</b>				<b>Serb</b>				<b>Boshnjak</b>				<b>Turq</b>		<b>Goran</b>		<b>Ashkalinj</b>		<b>Rom</b>		<b>Gjithësej</b>					
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F				
21	9	0	0	1	2	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	23	11								
31				0				3				0		0		0		1		35					
<b>Gjykata themelore</b>												<b>PRIZREN</b>		<b>Aprovuara</b>		<b>35</b>		<b>Plotësuara</b>		<b>28</b>		<b>Lira</b>		<b>7</b>	
<b>Shqiptar</b>				<b>Serb</b>				<b>Boshnjak</b>				<b>Turq</b>		<b>Goran</b>		<b>Ashkalinj</b>		<b>Rom</b>		<b>Gjithësej</b>					
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F				
15	9	0	0	1	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	17	11						
24				0				3				0		0		0		1		28					
<b>Dega gjyqësore në</b>												<b>SUHAREKË</b>		<b>Aprovuara</b>		<b>8</b>		<b>Plotësuara</b>		<b>5</b>		<b>Lira</b>		<b>3</b>	
<b>Shqiptar</b>				<b>Serb</b>				<b>Boshnjak</b>				<b>Turq</b>		<b>Goran</b>		<b>Ashkalinj</b>		<b>Rom</b>		<b>Gjithësej</b>					
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F				
4	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	4	1						
5				0				0				0		0		0		0		5					
<b>Dega gjyqësore në</b>												<b>DRAGASH</b>		<b>Aprovuara</b>		<b>3</b>		<b>Plotësuara</b>		<b>2</b>		<b>Lira</b>		<b>1</b>	
<b>Shqiptar</b>				<b>Serb</b>				<b>Boshnjak</b>				<b>Turq</b>		<b>Goran</b>		<b>Ashkalinj</b>		<b>Rom</b>		<b>Gjithësej</b>					
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F				
1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	1						
2				0				0				0		0		0		0		2					
<b>Dega gjyqësore në</b>												<b>Aprovuara</b>		<b>0</b>		<b>Plotësuara</b>		<b>0</b>		<b>Lira</b>		<b>0</b>			
<b>Shqiptar</b>				<b>Serb</b>				<b>Boshnjak</b>				<b>Turq</b>		<b>Goran</b>		<b>Ashkalinj</b>		<b>Rom</b>		<b>Gjithësej</b>					
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F				
0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0				
0				0				0				0		0		0		0		0					
<b>Dega gjyqësore në</b>												<b>Aprovuara</b>		<b>0</b>		<b>Plotësuara</b>		<b>0</b>		<b>Lira</b>		<b>0</b>			
<b>Shqiptar</b>				<b>Serb</b>				<b>Boshnjak</b>				<b>Turq</b>		<b>Goran</b>		<b>Ashkalinj</b>		<b>Rom</b>		<b>Gjithësej</b>					
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F				
0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0				
0				0				0				0		0		0		0		0					







	0	0	0	0	0	0	0	0
Komenti:								

3.

Nga Gjykatat themelore + Degët e gjykatës							
1. Shfrytëzimi i pushimeve							
Për të punësuarit në Gjykatë	Me pagesë				Pa pagesë		
	Vjetor	Mjekësor	Lehonie	Përdëllimit	Ngritje profesionale	Kujdes familjar	Tjetër
Gjyqtar							
Nëpunës							
Total:	0	0	0	0	0	0	0
Komenti:							
2. Procedurat e rekrutimit:							
Për të punësuarit në Gjykatë	Te shpallura:			Lloji i kontrates		Rezultati i konkurseve	
	Konkurse te jashtme	Konkurse te brendshme	Nr. i kandidateve konkurrues	Karrieres / Jo karrieres	Punes	Pozitiv	Negativ



2. Gjendja aktuale me aktivite te burimeve njerezore

Gjyqtar							
Nëpunës							
Total:	0	0	0	0	0	0	0
Komenti:							
<b>3. Disiplinimi:</b>							
Për të punësuarit në Gjykatë	Disiplinimi	Komisioni i brendshem		Shkalla e dyte		Lloji i masës	
	Numri i Disiplinimeve	Disiplinuar	Liruar	Disiplinuar	Liruar	Mase e lehte disiplinore	Mase e rende disiplinore
Gjyqtar							
Nëpunës							
Total:	0	0	0	0	0	0	0
Komenti:							
<b>4. Ankesat në përgjithësi:</b>							
Për të punësuarit në Gjykatë	Ankimimet			Komisioni i brendshem		Shkalla e dyte	
	Numri i ankesave	Ankese per rekrutim	Ankese tjeter	Miratuar	Refuzuar	Miratuar	Refuzuar
Gjyqtar							
Nëpunës							
Total:	0	0	0	0	0	0	0
Komenti:							



Nga Gjykatat themelore + Degët e gjykatës

1. Për programin e buxhetuar të gjykatës për vitin 2022, shprehur në Euro valutë:

Periudha:	Destinacioni i parasë:	Të buxhetuara:	Të shpenzuara:	Të pa shpenzuara:
Çereku: I./2023	a. Paga dhe mëditje			
	b. Mallra dhe shërbime	72,000.00 €	29,997.35 €	42,002.65 €
	c. Shpenzime komunale	12,900.00 €	3,380.00 €	9,520.00 €
	d. Investime kapitale			
	Në përgjithësi:	84,900.00 €	33,377.35 €	51,522.65 €

Komenti:

Periudha:	Destinacioni i parasë:	Të buxhetuara:	Të shpenzuara:	Të pa shpenzuara:
Çereku: II./2023	a. Paga dhe mëditje			- €
	b. Mallra dhe shërbime			- €
	c. Shpenzime komunale			
	d. Investime kapitale			
	Në përgjithësi:	- €	- €	

Komenti:

Periudha:	Destinacioni i parasë:	Të buxhetuara:	Të shpenzuara:	Të pa shpenzuara:
Çereku: III./2023	a. Paga dhe mëditje			- €
	b. Mallra dhe shërbime			- €
	c. Shpenzime komunale			- €
	d. Investime kapitale			
	Në përgjithësi:	- €	- €	- €

Komenti:

Periudha:	Destinacioni i parasë:	Të buxhetuara:	Të shpenzuara:	Të pa shpenzuara:
	a. Paga dhe mëditje			- €
	b. Mallra dhe shërbime			- €



Hyrje/daljet  
financiare

Çereku: IV./2023	c.	Shpenzime komunale				- €
	d.	Investime kapitale				- €
	Në përgjithësi:			- €	- €	- €

Komenti:

Nga Gjykatat themelore + Degët e gjykatës

2.1. Të hyrat në buxhetin e Kosovës

Nga periudhat:	Të inkasuara në Euro valutë, sipas bazës paguese					Gjithësej
	Taksë	Dënim	Paushall	komp.viktim	Konfiskim	
I./2023	109,571.88 €	194,998.50 €		13,000.00 €		317,570.38 €
II./2023						- €
III./2023						- €
IV./2023						- €
Gjithësej:	109,571.88 €	194,998.50 €	- €	13,000.00 €		317,570.38 €

Komenti:

Nga Gjykatat themelore + Degët e gjykatës

2.2. Për të hyrat në Thesarin (Trezorin) e Kosovës

Nga periudhat:	Të inkasuara në Euro valutë, sipas bazës paguese					Gjithësej
	Garancion për kontest	Depozitim (pignus) gjyqësor	Corpus delicti	Parapagim për shpenzime	Për raste tjera	
I./2023		22,703.00 €				22,703.00 €
II./2023						- €
III./2023						- €
IV./2023						- €
Gjithësej:		22,703.00 €				22,703.00 €

Komenti:



5.

5. Çështje  
Logjistike

6.

6. Prokurimi Publik	Numri i prokurimit publik	Lloji i kërkesës	Shuma	Realizimi	
				po	jo
			- €	0	0
			- €	0	0
			- €	0	0
			- €	0	0
			- €	0	0
E përgjithshme prej: 01.01.2020-31.12.2020			- €	0	0

7.

7. Projektet e  
realizuara

1. Numri i projektit
  2. Emërtimi i projektit:
  3. Partnerët e projektit:
  4. Vlera e projektit:
  5. Të involvuarit në projekt:
  6. Kostoja e projektit:
  7. Rezultatet e projektit:
- Komenti:



8.

8. Identifikimi i pengesave në punët për vendimarrje lidhur me paqartësi ligjore në zbatim

Në lidhje me indentifikimin e pengesave për vendimarrje dhe paqartësi në zbatim duhet të cekim se sa i përket numrit të stafit mbështetës me zyrtar ligjor , referenta, dorëzues dhe zyrtar të arkivës nuk kemi plotësuar në numër të mjaftueshëm duke pasur parasysh se disa zyrtarë nga këto vende të punës janë pensionuar , suspenduar ose kanë dhënë dorëheqje dhe në përgjithësi vendet e tyre të punës nuk janë plotësuar në numër të duhur. Kjo paraqet pengesë në organizimin e punës dhe realizim të objektivave Për paqartësi ligjore në zbatim nuk kemi ndonjë vërejtje të veçantë.

9.

9. Mbledhjet e mbajtura lidhur me menaxhimin e gjykatës dhe lëndëve gjyqësore

Kryetarja e gjykatës kanë mbajtur mbledhjen me gjyqtarë të secilit Departament dhe Divizion në lidhje me Strategjinë e KGJK -së dhe programin e paraparë për tejkalim të problemeve. Gjithashtu është mbajtur mbledhje e veçantë me bashkëpunëtorët profesional për punën e organizimit të mbështetjes së punës së gjyqtarve në tërësi si dhe kryerjes së punëve të tyre në veqanti.Me administratoren e gjykatës kryetarja ka mbajtur mbledhjen me stafin administrativ ku edhe janë kryer disa ndryshime në organizim . Janë bërë ndryshime në zyrën e ekzekutimeve të divizionit të kundërvajtjes , në punën e sekretareve ligjore te disa gjyqtarë dhe ndryshime në plotësimin e vendit të punës së arkivistit.

10.



10. Identifikimi i pengesave në punë dhe propozimi i masave për tejkalimin e tyre

Pengesat në punë janë paraqitur si më lartë dhe propozimi për tejkalim të këtyre pengesave është që të plotësohen vendet e punës në administratë dhe më pas edhe të bëhet edhe një herë riorganizim në mënyrë që të tejkalohen pengesat e gjerëtanishme

11.

11. Bashkëpunimi i gjykatës me subjektet jo gjyqësor kombëtar dhe ndërkombëtar.

Gjykata ka bashkëpunim të mirëfilltë me organizatat ndërkombëtare si OSCE dhe USAID , kurse me subjekte jogjyqësore ka bashkëpunim me Komunën e Prizrenit, Strehimoren , mbrojtësit të viktimave , ka gadishmëri që të bashkëpunojë me secilin subjekt jo gjyqësor në suaza profesionale dhe në raste kur nuk ndikon në punën e tërësishme të gjykatës. Bashkëpunim të veçantë gjykata ka me Prokurori dhe Polici

12.

12. E rëndësishme së veçantë për paraqitje në KGJK

Është e rëndësishme së veçantë për paraqitje në KGJK se në kuadër të Gjykatës Themelore në Prizren është funksionalizuar objekti i ri i gjykatës ku janë vendosur gjyqtarët që punojnë në Divizionin Civil së bashku me stafin mbështetës dhe kjo gjykatë është duke funksionuar shumë mirë , por në oborin e gjykatës end ejanë lëndët të cilat duhet të asgjësohen dhe e kanë bllokuar tërësisht pasi që në programin e asgjësimit janë 300.000 lëndë të cilat janë gati që të përfundojnë dhe të gjitha këto lëndë janë në oborr të gjykatës. Prandaj në këtë drejtim edhe një herë kërkohet që të organizohet nga ana e KGJK -së procedura e asgjësimit pasi që ne kemi përfunduar pjesën tonë të

## II. Treguesit statistikor për lëndët gjyqësore:

### III. Përmbyllja

1

Rekomandime për KGJK	Rekomandimet për KGJK-në janë : Të plotësohen vendet e lira të punës së stafit administrativ; të përfundojë puna e funksionalizimit të objektit të ri të gjykatës me asgjësim të lëndëve; të bëhet gëlqerosja e objektit të gjykatës ; të ndihmohet në mirëmbajtje të arhivave dhe të modernizohen të njejtat me ndonjë sistem mbështetës të arkivimit dhe në tërësi të bëhet mbështetja e punëve rreth stafit administrativ
----------------------	--

2

Përfundim përmblendhës	Si përfundim mund të cekim se e gjithë puna e gjykatës duhet të jetë në koordinim me KGJK-në në mënyre që të zbatohet Strategjia e aprovuar si dhe të realizohen objektivat e strategjisë
------------------------	---

**Kryetarja e gjykatës**

(nënshkrimi)

